



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr.519/5 Prot

Tiranë, më 26.4.2023

**VENDIM**

**Nr.16, datë 26.4.2023**

**PËR**

**RRËZIMIN E ANKESËS**

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar,

**KONSTATOVA SE:**

Ankuesja, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 519 Prot., datë 06.03.2023, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik “Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesja, me anë të kërkesës datë 01.02.2023, depozituar në adresën [koordinatorimfa@mfa.gov.al](mailto:koordinatorimfa@mfa.gov.al), ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni, si vijon:

- 1- *Një kopje të plotë të kontratës së nënshkruar ndërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe kompanisë “APCO WORLDWIDE”, referuar vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 115, datë 23.02.2018.*
- 2- *Në rast se kontrata është klasifikuar sekret, një kopje të urdhrin të lëshuar nga titullari për ngritjen e “Komisionit të shqyrtimit të informacionit të klasifikuar” për klasifikimin e kontratës së nënshkruar, ndërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe kompanisë “APCO WORLDWIDE”, si sekret shtetëror referuar VKM nr. 123, datë 15.3.2001 “Për rregullat e procesit të klasifikimit të sekretit shtetëror”.*

- 3- Një kopje të procesverbalit të mbledhjes së kryer nga “Komisioni i shqyrtimit të informacionit të klasifikuar” për klasifikimin e kontratës së nënshkruar, ndërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe kompanisë “APCO WORLDWIDE”, si sekret shtetëror referuar VKM nr. 123, datë 15.3.2001 “Për rregullat e procesit të klasifikimit të sekretit shtetëror”.
- 4- Një kopje të raportit të mbledhjes së kryer nga “Komisioni i shqyrtimit të informacionit të klasifikuar” ku argumentohen arsyet për klasifikimin e kontratës së nënshkruar, ndërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe kompanisë “APCO WORLDWIDE”, si sekret shtetëror, referuar VKM-së nr. 123, datë 15.3.2001 “Për rregullat e procesit të klasifikimit të sekretit shtetëror”.

Autoriteti Publik, nëpërmjet e-mail-it datë 13.02.2023, ka sqaruar se: “...Me kërkesën e datës 17.06.2019 në cilësinë e gazetares së OCCRP keni bërë kërkesë pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme se për të njëjtin objekt kërkesë, për të cilën kemi kthyer përgjigje se VKM nr. 115/2018 si dhe çdo akt tjetër në zbatim të saj është një dosje e klasifikuar në mbështetje të ligjit nr. 8457/1999 “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”, si rrjedhojë gjen mbështetje në dispozitat kufizuese të Kreu IV neni 17, të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Bazuar në pikën 12, të VKM-së nr. 123, datë 15.3.2001 “Për rregullat e procesit të klasifikuar të sekretit shtetëror” të cilën referoni (në fuqi në atë kohë) shprehej si vijon: 12. Kur një informacion është i klasifikuar, e gjithë praktika ku bën pjesë ai të klasifikohet në nivelin e këtij informacioni.

Për sa më sipër, referuar praktikës në të cilin është realizuar kontrata, rezultojnë dokumente ligjore të klasifikuara të cilat përmbajnë klauzola detyruese për kontratën; për rrjedhojë edhe kontrata mban të njëjtin nivel klasifikimi.

Gjendur në të njëjtat kushte bëjmë me dije se informacioni që kërkoni nuk mund t’ju vihet në dispozicion”.

Në vijim të përgjigjes së sipërcituar, ankuesja ka paraqitur ankimin pranë Zyrës së Komisionerit, duke kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit nga Autoriteti Publik.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se: “Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”, Zyra e Komisionerit,

me e-mail-in datë 09.03.2023 kërkoi qëndrimin e Autoritetit Publik në lidhje me ankesën nr.519 Prot., datë 06.03.2023.

Koordinatorja për të drejtën e informimit pranë Autoriteti Publik, me e-mail-in datë 17.03.2023, ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: “...sjellim në vëmendjen se kërkesa aktuale është përsëritje e kërkesës së mëparshme, të datës 17.06.2019, për të cilën kemi kthyer përgjigje se VKM nr. 115/2018 si dhe çdo akt tjetër në zbatim të saj është një dosje e klasifikuar në mbështetje të ligjit nr.8457/1999 “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”. Për rrjedhojë, mbështetur në dispozitat kufizuese të Kreut IV, neni 17, i ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, informacioni nuk mund t’i vihet në dispozicion.

Për sa i takon kërkimit për pikat 2 dhe 3, vlerësojmë se nga ana e ankueses ka një keqinterpretim të VKM-së nr. 123, datë 15.3.2001 “Për rregullat e procesit të klasifikimit të sekretit shtetëror, procedurat që përdoren për identifikimin e tij dhe të delegimit të autoritetit të klasifikimit”. Sipas këtij Vendimi, pranë çdo institucioni që ka të drejtën e klasifikimit origjinal krijohet, me urdhër të titullarit, “Komisioni i shqyrtimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”” me jo më pak se 5 anëtarë, kryetar i të cilit është titullari ose i deleguari i tij. Ky komision shqyrton llojet e dokumentacionit që prodhon institucioni dhe propozon atë kategori dokumentesh që duhen klasifikuar, rivlerësuar, nivelin e klasifikimit dhe afatin e ruajtjes së këtij niveli. Lista nuk përmban informacion të klasifikuar në vetvete por vetëm kategori (grupime të përgjithshme) të informacioneve të klasifikuara “sekret shtetëror” që mund të prodhojë MEPJ gjatë ushtrimit të funksionit të saj.

Në kërkesën 2 dhe 3 ankuesja lë të kuptohet se dispozitat e lartpërmendura detyrojnë ngritjen dhe/ose mbledhjen e Komisionit rast pas rasti për të përcaktuar nëse një praktikë konkrete është për t’u trajtuar dhe administruar si informacion i klasifikuar ose jo; për më tepër, të tregohen arsyet pse duhet bërë ose jo klasifikimi i kësaj praktike. Ky është një interpretim në kundërshtim me frymën e legjislacionit për IK. Nëse do ekspozohet arsyetimi konkret që qëndron në thelb të klasifikimit të informacionit i bie të ekspozojmë të dhëna nga elementët e sigurisë kombëtare që ky informacion prek. Referuar praktikës së kontratës së klasifikuar, e gjithë praktika administrohet si e tillë dhe i nënshtrohet dispozitave të ligjit për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”.

Në vijim të qëndrimit të Autoritetit Publik, ankuesja ka vijuar me ankimin e regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 519/2 Prot., datë 21.03.2023.

Në këto kushte, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI, në të cilin parashikohet se: “...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”, bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore, e cila u zhvillua me datë 30.03.2023, me prezencën e ankueses dhe përfaqësuesëve të Autoritetit Publik.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesja rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesë. Ndërkohë, përfaqësuesit e Autoritetit Publik u shprehën se: “...Informacioni i kërkuar çënon sigurinë kombëtare, sipas përkufizimit të bërë nga legjislacioni për informacione të klasifikuara. Komisioni i ngritur pranë Autoritetit Publik është i përhershëm dhe investohet në çdo kohë nga çdo qytetar apo person i interesuar”.

Në përfundim të seancës dëgjimore, Zyra e Komisionerit i la detyrë përfaqësuesëve të Autoritetit Publik, për të përcjellë qëndrimin përfundimtar në lidhje me këtë çështje, në raport me procedurën e parashikuar në pikën 5 të nenit 17 të LDI brenda datës 05.04.2023.

Në vijim, Autoriteti Publik, me e-mail-in datë 05.04.2023, rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në aktet shkresore të trajtuara më sipër, duke cituar ndër të tjera se: “...Në vijim të seancës dëgjimore të zhvilluar nga Zyra e Komisionerit mbi ankimin e zj. Çela, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme iu la detyrë të shprehej mbi procedurën e ndjekur referuar pikës 5 të nenit 17 të LDI. Sipas këtij parashikimi, e drejta e informimit nuk refuzohet automatikisht kur informacioni i kërkuar gjendet në dokumente të klasifikuara “sekret shtetëror”. Në këtë rast, autoriteti publik, të cilit i është dërguar kërkesa për informim, fillon menjëherë procedurën e rishikimit të klasifikimit pranë autoritetit publik që ka urdhëruar klasifikimin, sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, të ndryshuar.

Rezulton se, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit “Sekret shtetëror” në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, ngritur me Urdhrin e Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 11, datë 25.01.2022, është mbledhur në datë 29.03.2023 për të shqyrtuar deklasifikimin/zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” objekt i kërkesës për informim të znj.

Me Vendimin e KDZH nr. 1, datë 29.03.2023, është vendosur mosdeklasifikimi i informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” objekt i kërkesës për informim të znj. datë 01.02.2023, drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Bazuar në Listën e informacioneve të klasifikuara “Sekret Shtetëror” në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme (pika nr.26) i miratuar me Vendimin nr. 22, datë 01.02.2023, relacioni dhe vendimi për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e IK ruhet në nivelin dhe afatin më të lartë të informacionit që trajtohet në këtë proces. Pra, Vendimi i kërkuar nga Kryetari përbën informacion të klasifikuar në vetvete.

Kërkesa për vënie në dispozicion e tij i errësuar/i palexueshëm në pjesën tërësore, përveçse dispozitivit, përbën “Deklasifikim të pjesshëm” në kuptim të nenit 22 (1, b) të ligjit 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”. Deklasifikimi i pjesshëm autorizohet vetëm nga KDZH. Për rrjedhojë, në mënyrë që Komisionerit t’i vihet në dispozicion Vendimi 1/2023 i KDZH i deklasifikuar pjesërisht, duhet që KDZH të rimblidhet për ta shqyrtuar atë dhe të vendosë deklasifikimin e pjesshëm...”

Ankuesja, pas përgjigjes së sipërcituar, nëpërmjet e-mail-it datë 07.04.2023, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 519/3 Prot., datë 07.04.2023, ka vijuar me ankimin, me pretendimin se: “Në vijim të sqarimit të bërë nga koordinatori për të drejtën e informimit i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, nëpërmjet e-mail-it datë

05.04.2023, pas seancës dëgjimore të zhvilluar nga Zyra e Komisionerit mbi ankimin e bërë nga OCCRP përfaqësuar nga zj. Çela, në lidhje me kërkesën për të na vënë në dispozicion dokumentet zyrtar/informacion në lidhje me kontratën e lombimit me kompaninë “APCO WORLDWIDE”, apo dhe procedurat e ndjekura për kalsifikimin e saj si sekret shtetëror, më lejoni të shpreh opinionin tim, se dhe pas sqarimit të bërë nga institucioni që disponon këto dokumente, përgjigjet nuk janë shteruese.

Së pari, sqarimi flet për procedurat e de klasifikimit, në asnjë rast në kërkesën time nuk është folur për këtë. Po kështu dhe në seancën dëgjimore, kemi insistuar për procedurat e ndjekura nga institucioni për klasifikimin e dokumenteve. Deklasifikimi është procedure pasuese.

Së dyti, edhe në emalin sqarues, që përcillet është vetëm ligji, apo dhe data mbledhjeshe ku nuk mbështeten në asnjë dokument zyrtar, qoftë ky dhe një numër protokolli.

Si rrjedhojë, duke e konsideruar dhe emalin sqarues të pa plotë dhe jo shterues sa i përket pikave që kanë qenë objekt i kërkesës sime drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, kërkoj nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit vijimin e procedurave, qoftë kjo dhe daljen me një vendim sa i përket ankimit të bërë në lidhje me kontratën e lombimit me kompaninë “APCO WORLDWIDE”.

Në vijim, Autoriteti Publik, me e-mail-in datë 24.04.2023, sqaron se: “Së pari, në plotësim të kërkesës së Zyrës së Komisionerit, bashkëlidhur përcjellim një kopje të skanuar të Vendimit të Komisionit për Deklasifikim dhe Zhvlerësim nr. 1, datë 29.03.2023, të ekspozuar vetëm në ato elementë të lirë për tu ekspozuar me Vendim të tij. Së dyti, në lidhje me ankimin e datës 07.04.2023 të zj. Çela si dhe pikat 2, 3 dhe 4 të kërkesës fillestare për informacion të datës 01.02.2023, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme nuk disponon informacionin që kërkohet. Këto kërkesa janë formuluar bazuar në një keqinterpretim të VKM-së nr. 123, datë 15.3.2001 “Për rregullat e procesit të klasifikimit të sekretit shtetëror, procedurat që përdoren për identifikimin e tij dhe të delegimit të autoritetit të klasifikimit” (referojuni përgjigjes ndaj ankimit dhe qëndrimin e mbajtur nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme gjatë seancës dëgjimore).”

Nga shqyrtimi i çështjes Komisioneri konstaton se objekti i kërkesës ka të bëjë me informacion, i cili është rregulluar nga dispozitat e ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për Informacionin e Klasifikuar Sekret Shtetëror”.

Autoriteti Publik në aktet shkresore të trajtuara më sipër, ka sqaruar se dokumentacioni objekt shqyrtimi është i klasifikuar. Konkretisht, ky autoritet ka informuar se, dokumentacioni i kërkuar në lidhje me pikën 1, të kërkesës për informacion është i klasifikuar sipas ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për Informacionin e Klasifikuar Sekret Shtetëror”.

Në këto kushte, në vijim të detyrës së caktuar nga Zyra e Komisionerit në seancë dëgjimore, Autoriteti Publik, ka trajtuar kërkesën në përputhje me parashikimet e nenit 17 të LDI ku në shkronjën “a” të pikës 2, parashikon se:

“2. E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm:



a) sigurinë kombëtare, sipas përkufizimit të bërë nga legjislacioni për informacionin e klasifikuar;

...

ndërsa në pikën 5 të dispozitës së sipërcituar ky ligj parashikon se:

... 5. E drejta e informimit nuk refuzohet automatikisht kur informacioni i kërkuar gjendet në dokumente të klasifikuara "sekret shtetëror". Në këtë rast, autoriteti publik, të cilit i është dërguar kërkesa për informim, fillon menjëherë procedurën e rishikimit të klasifikimit pranë autoritetit publik që ka urdhëruar klasifikimin, sipas ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", të ndryshuar. Autoriteti publik njofton menjëherë kërkuuesin për fillimin e procedurës për rishikimin e klasifikimit, sipas ligjit, dhe vendos shtyrjen e afatit për dhënien e informacionit brenda 30 ditëve pune. Në çdo rast, vendimi për trajtimin ose jo të kërkesës për informim merret dhe arsyetohet në bazë të kriterëve të këtij neni."

Lidhur me pretendimin e ankueses se Autoriteti Publik flet për procedurat e deklasifikimit, dhe në asnjë rast në kërkesën time nuk është folur për këtë. Po kështu dhe në seancën dëgjimore, kemi insistuar për procedurat e ndjekura nga institucioni për klasifikimin e dokumenteve pasi deklasifikimi është procedure pasuese, Komisioneri vlerëson se këto argumenta nuk qëndrojnë, pasi, Autoriteti Publik në çdo përgjigje zyrtare ka sqaruar se kjo procedurë është e klasifikuar. Fakte këto, të cilat i vërteton edhe mbledhja e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar, i cili me vendimin nr. 1, datë 29.03.2023, ka vendosur mosdeklasifikimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror" objekt i kërkesës për informim të znj. datë 01.02.2023, drejtuar Autoritetit Publik.

Vendim ky i cili është vendosur në dispozicion edhe të ankueses me e-mail-in datë 24.04.2023, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të LDI.

Për sa më sipër, pavarësisht se në parim informacioni i kërkuar në pikën 1 të kërkesës për informacion drejtuar Autoritetit Publik, përbën informacion publik në kuptim të pikës 2, të nenit 2, të LDI, Komisioneri vlerëson se në rastin konkret e drejta për informim kufizohet në përputhje me shkronjën a) të pikës 2 të nenit 17 të këtij ligji.

Për sa i përket pikave 2, 3 dhe 4 të kërkesës për informacion, Autoriteti Publik, ka sqaruar se, sipas VKM-së nr. 123, datë 15.3.2001 "Për rregullat e procesit të klasifikimit të sekretit shtetëror, procedurat që përdoren për identifikimin e tij dhe të delegimit të autoritetit të klasifikimit", pranë çdo institucioni që ka të drejtën e klasifikimit origjinal krijohet, me urdhër të titullarit, "Komisioni i shqyrtimit të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror" me jo më pak se 5 anëtarë, kryetar i të cilit është titullari ose i deleguari i tij. Ky komision shqyrton llojet e dokumentacionit që prodhon institucioni dhe propozon atë kategori dokumentesh që duhen klasifikuar, rivlerësuar, nivelin e klasifikimit dhe afatin e ruajtjes së këtij niveli. Lista nuk përmban informacion të klasifikuar në vetvete por vetëm kategori (grupime të përgjithshme) të informacioneve të klasifikuara "sekret shtetëror" që mund të prodhojë Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme gjatë ushtrimit të funksionit të saj. Në kërkesën 2... ankuesja lë të kuptohet se dispozitat e lartpërmendura detyrojnë ngritjen dhe/ose mbledhjen e Komisionit rast pas rasti për të përcaktuar nëse një praktikë konkrete është për t'u trajtuar dhe administruar

*si informacion i klasifikuar ose jo; për më tepër, të tregohen arsyet pse duhet bërë ose jo klasifikimi i kësaj praktike...*

*Për këto arsye për pikat 2, 3 dhe 4 të kërkesës për informacion të datës 01.02.2023, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme nuk disponon informacionin që kërkohet..."*

Në këto kushte, kur Autoriteti Publik ka deklaruar se nuk e zotëron informacion e kërkuar për këto pika, rrjedhimisht kjo kërkesë nuk përmbush elementët e pikës 2 të nenit 2 të LDI, në të cilën parashikohet se: *"informacion publik" është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik".*

## **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjën c) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar,

## **V E N D O S A:**

1. Rrëzimin e ankesës me nr. 519 Prot., datë 06.03.2023, të znj. \_\_\_\_\_, kundër Autoritetit Publik "Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme", me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*".
2. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
3. Ky vendim u shpall sot në datë 26.4.2023.

## **KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**